

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare
Nr. 02-49/10-07
Prishtinë, më 5 prill, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Fjala e hapjes e kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha
2. Fjala e kryetarit të Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjerë të Grupit Negociator dhe
3. Miratimi i Deklaratës.

1. Fjala e hapjes e kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për procesin e diskutimit që kishte nisur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e statusin të Kosovës. I Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara, z. Ahtisari, më 3 prill kishte paraqitur dhe argumentuar raportin e tij për Kosovën. Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për Kosovën. Pardje, për herë të parë, në KS e OKB-së, në formë zyrtare u dëgjua fjala e presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiu.

Propozimin e z. Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës e mbështetën SHBA-të, Bashkimi Evropian, shtete të tjera të botës dhe vetë sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, z. Ban Ki Mun. Kjo nënkupton fundin e robërisë dhe fillimin e realizimit të sigurt dhe shumë të shpejtë të aspiratave krejtësisht ligjore të këtij populli për të jetuar i lirë dhe sovran në trojet e veta.

Sot jemi mbledhur në këtë seancë plenare, që përmes miratimit të një deklaratë, t'i dërgojmë Botës një porosi të qartë për përkrahjen e planit të z. Ahtisaari dhe ta falënderojmë atë për punën e madhe, si dhe të gjithë ata që e përkrahin çështjen tonë.

2. Fjala e kryetarit të Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjerë të Grupit Negociator

Kryetari e ftoi kryetarin e Kosovës ta merrte fjalën.

Kryetari i Kosovës, dr. **Fatmir Sejdiu** i informoi deputetët e Kuvendit për zhvillimet e fundit në seancën e KS të OKB-së, si dhe për adresimin e presidentit Ahtisaari para anëtarëve të KS për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Pakoja e përgjithshme e presidentit Ahtisari, e dorëzuar ditë më parë bashkë me dokumentin e rekomandimeve, u është dorëzuar anëtarëve të KS më 26 mars 2007 dhe sipas procedurave të KS ai e ka paraqitur ekspozenë e tij më 3 prill 2007.

Presidenti Ahtisari në plotëni e ka argumentuar qëndrimin e tij, në raportin për të ardhmen e Kosovës dhe bashkë me pjesën e rekomandimeve politike parasheh pavarësinë e Kosovës me një mbikëqyrje ndërkombëtare, me një prani civile ndërkombëtare dhe me trupat e NATO-s për një periudhë të ardhshme.

Në takimin e KS është prezantuar edhe një fjalë imja, që është transmetuar përmes PSSP-së të OKB-së në Kosovë, z. Ryker.

Është e rëndësishme se në këtë proces fillon procedimi i konkretizuar në drejtim të një vendimi konkret që duhet ta marrë KS në mbështetje të këtij dokumenti të rëndësishëm.

Ne, si Kosovë u kemi dhënë mbështetje qëndrimeve të shprehura në pakon e përgjithshme të presidentit Ahtisari edhe dokumentit të rekomandimeve, duke e konsideruar si një dokument të balancuar, në të cilin kemi bërë kompromiset tona për hir të së ardhmes së Kosovës, për hir të së ardhmes së gjithë qytetarëve të saj.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës në seancën e sotme ta miratojë një deklaratë me të cilën mirëpret në tërësi raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës z. Ahtisari.